



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC**

Adresa: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Nr.113/1prot.

Pogradec, më 12.09.2016

RAPORT FINAL

**MBI AUDITIMIN E PROCEDURAVE TË SHËRBIMIT NË SEKTORIN E
TRANSPORTIT DHE SUPERVIZIMIT TË SHËRBIMEVE NË BASHKINË
POGRADEC PËR VITIN 2015**

Drejtuar: Sektorit të transportit dhe supervizimit të shërbimeve

Në zbatim të Ligjit nr.114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin në sektorin publik", Manuali I auditimit të brendshëm miratuar me urdhrin nr.69 dt.29.09.2010 të Ministrisë të Financave, Plani vjetor I Auditimit 2016, Ligji nr.139/2015 date 17/12/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", Kodin Rrugor, Ligjin nr.8308dt.18.03.1998 "Për transportin rrugor" I ndryshuar, VKM nr.325 dt.19.03.2008 "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve si dhe për njohjen e dok. zyrtare të caktuara për ta.", Udhëzimi nr.1649 dt.16.08.1999 "Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve", në planin e punës të miratuar nga titullari për vitin 2016 dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.12 dt.5.6.2012 "Mbi procedurat e kryerjes së auditimit të brendshëm në sektorin publik" përgatiti këtë raport final.

I. SEKTORI I TRANSPORTIT

Për vitin 2015 në sektorin e transportit 28 subjekte kanë marre certifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet, për të tretët dhe me qera brenda vendit. Nga këto u verifikuan 10 dosje. Gjatë auditimitu vunë re sa më poshtë:

Në bazë të Udhëzimit nr.15 dt 24/07/2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", kreu V, neni 15 në dosjet e lartpërmenura mungon formular I autodeklarimit sipas aneksit 3 dhe dokumenti I kredibilitetit bankar, dokumenti që zotëron kompetencën profesionale(me përjashtim të transportit për llogari të vet) dokumentacioni I paraqitur është fotokopje(duhet original ose kopje e noterizuar sipas nenit12, pika 2), materiali I zyrës së liçencave I miratuar nga eprori(drejtori I DPP), dhe vendimi I kryetarit(në zbatim të nenit 12 pika 3), në dosje duhet të mbahet një kopje origjinale e Licencës/certifikatës(sipas nenit 13). Në rastet e shoqërive duhet të përcaktohet administrator ose I autorizuar prej tij me akt-noterial sipas nenit 12 pika 1.

II. Për vitin 2015 në sektorin e transportit 79 subjekte kanë marre Liçencë për transport udhëtarësh brenda vendit për llogari të vet, për të tretët dhe me qera brenda vendit. Nga këto u verifikuan 10 dosje.

Gjatë auditimitu vunë re sa më poshtë: Në bazë të Udhëzimit nr.15 dt 24/07/2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe certifikatave për

ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, kreu V, neni 15 në dosjet e lartpërmenura mungon formular I autodeklarimit sipas aneksit 3 dhe dokumenti I kredibilitetit bankar, dokumenti që zotëron kompetencën profesionale(me perjashtim të transportit për llogari të vet), ekstakt QKR, dokumenti për veifikimin dhe plumbosjen e taksimetrit lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe kalibrimit (neni 21). Në dosje duhet të mbahet një kopje origjinale e Licencës/certifikatës(sipas nenit 13) nuk ka dokumentacion që të përcaktojë pikën e hipjes dhe të zbritjes së udhëtareve, nuk shoqërohen me certifikatën e automjetit(neni 36. Në kërkesat për rinovim të certifikatave të automjeteve subjektet duhet te paraqesin edhe evidencën statistikore vjetore(neni 16). Në rastin e shoqërive kërkesa të plotësohet me të dhëna të sakta ku të kuptohet lidhja midis shoqërisë dhe shoferit. Mungon një fletë llogaritje për cdo dosje të detyrimeve përkatëse.

II. SUPERVIZIMI I SHËRBIMEVE

Në dt.16.01.2015 Bashkia Pogradec me cilësinë e autoritetit kontraktor/investitorit ka lidhur me operatoret ekonomike “REJ” sh.p.k.& “SHPRESA” në cilësinë e kontraktuesit, kontratën me objekt “Pastrimi, Grumbullimi dhe Largimi i Mbeturinave të Qytetit Pogradec” me vlerë 198.062.504 lekë me tvsh dhe me afat 5 vjet deri më 15.01.2020. pjesë e kësaj kontratë është tabela e sipërfaqeve të rrugëve që do të fshihen dhe mirëmbahen, bashkangjitur kontratës së lidhur midis palëve me datë 16.01.2015, hartuar nga Komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr. 115, datë 25.10.2013. **Ky komision i përbërë nga F.Buzo, Dh.Gjata, V.Xhoga, Z.Ruvina, T.Buzo dhe E.Lipi nuk ka firmosur tabelat** në të cilat konstatohet se ka dublim rrugesh përkatësisht janë llogaritur *dy herë rrugët “ Gani Homçani ” me sipërfaqe 3850 m²* në procesin e fshirjes dhe “Gent” me sip. 1570 m² në procesin e mirëmbajtjes. Konsatimi i mësipërm është bërë edhe nga supervizori i kësaj kontrate E.Marjani dhe është evidentuar tek proces-verbalet mujore me objekt “Pastrimi, Grumbullimi dhe Largimi i Mbeturinave të Qytetit Pogradec” të mbajtuara midis palëve, për periudhën 16 Janar 2015 deri 31 Dhjetor 2015 dhe është kryer zbritja në Lekë sipas procesverbaleve mujore, të cilat janë reflektuar në situacionet mujore të kësaj periudhe, vlera 237,398 Lekë në total.

Duke patur parasysh sa më lart vihet re se dublimi ka qënë gabimi i komisionit të lartpërmendur I cili ka patur për detyrë në bazë të Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr. 115, datë 25.10.2013 pregatitjen dhe llogaritjen përkatëse të tabelave të procesi të fshirjes dhe mirëmbajtjes. Gjithashtu në momentin e konstatimit të këtij të ashtuquajtur “Lapsus” duhet të ishte njoftuar eprori direkt i investitorit “Bashkia Pogradec” për amendimin e kontratës së mësipërme për të zbritur vlerën e dubluar.

Preventivi i pastrimit të qytetit të Pogradecit(pse për 2014??) përmban 12 zëra por nuk shoqërohet me analizë të çmimeve.

Për çdo muaj supervizori për të gjitha shërbimet(fshirja, mirëmbajtja, ngarkim mbetje familjare, plugim sipërfaqe ranore, ngarkim mbetja inerte, dizinfektim, lagie e rrugëve, shtyrja e mbeturinave, mirëmbajtje e lumenjëve, ngarkim mbetje plazhi dhe hedhje kripë në rrugë), ka pregatitur një përmbledhje të përbërë nga:situacioni i muajit përkatës, tabela e ndalesave, procesverbal nr.2 për ndalesen e dyblimit të rrugëve, procesverbal nr.1 për fshirjen me fshesë, tabela e llogaritjes se ndaleses totale mujore, procesverbal për mbetjet inerte, procesverbal për dizinfektimin e kontenierëve, procesverbal për mirëmbajtjen e dy lumenjëve, procesverbal lagie rrugësh, ftetët e udhëtimiti nr.1, nr.2, nr.3, dy procesverbale të fshehtë kontrolli, procesverbal për

shtyrje mbeturinash urbane në venddepozitim, foto, raport mujor, procesverbale-ditar objekti nga 01 deri në 31dhjetor 2015.

Supervizimi dhe zbatimi i kontratës së pastrimit të qytetit është kontrolluar nga auditët e Kontrollit të Lartë të shtetit bazuar në raportin përfundimtar nr.389/10prot. Dt.14.07.2016.

Në dt.26.08.2016 në **Sektorin e transportit dhe supervizimit të shërbimeve** u dërgua projekt-raporti nr.173prot.. Në dt.31.08.2016 ish punonjësi L.Elmasllari ish punonjës i **Sektorit të transportit** ka sjellë një observim(brenda 10 ditëve pune nga dorëzimi I projekt-raportit) I cili u lexua me vëmendje nga punonjësit e Njesisë së brendshme të auditimit dhe u pranuan shpjegimet.

Përfundimisht, Njësia e auditimit të Brendshëm del në konkluzionin se përgjithësisht **Sektori i transportit dhe supervizimit të shërbimeve** ka realizuar një veprimtari në përputhje me legjislacionin përkatës megjithatë për përmirësimin e punës në të ardhmen mbështetur në kërkesat e ligjit nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me auditimin e brendshëm të miratuar nga Ministri I Financave. **REKOMANDOJMË:**

1. Sipas Udhëzimi nr.15 dt 24/07/2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, kreu V, neni 15 të kërkohej dhe plotësohej: formulari I autodeklarimit sipas aneksit 3 dhe dokumenti I kredibilitetit bankar, dokumenti që zotëron kompetencën profesionale(me përjashtim të transportit për llogari të vet), ekstakt QKR, dokumenti për verifikimin dhe plumbosjen e taksimetrit lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe kalibrimit (neni 21).
2. Në dosje duhet të mbahet një kopje origjinale e Licencës/certifikatës(sipas nenit 13) si dhe të ketë dokumentacion që të përcaktojë pikën e hipjes dhe të zbritjes së udhëtareve, të shoqërohen me certifikatën e automjetit(neni 36).
3. Në kërkesat për rinovim të certifikatave të automjeteve subjektet duhet të paraqesin edhe evidencën statistikore vjetore(neni 16). Në rastin e shoqërive kërkesa të plotësohet me të dhëna të sakta ku të kuptohet lidhja midis shoqërisë dhe shoferit.
4. Çdo dosje të ketë një fletë të llogaritjes së detyrimeve përkatëse.

Në zbatim të ligjit nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, subjekti **Sektorin e transportit dhe supervizimit të shërbimeve**,të marrë masa të plota për zbatimin e rekomandimeve sipas kësaj shkrese. Subjekti që është audituar të njoftojë me shkrim NJAB-në për realizimin e rekomandimeve herë pas here sipas afateve të përcaktuara.

NJËSIA E AUDITIMIT

Llazi Deti

Juriste: Kleda Vako

Për Sektorin e transportit dhe supervizimi I shërbimeve